



Nr. 1850 prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Elbasan, më 21.09.2021

VENDIM

Nr. 35 datë 21.09.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 38.DATË 26.09.2021 TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TE STUDIMIT MASTER PROFESIONAL NË "MËSUES NDIHMËS NË ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS" NË DEPARTAMENTIN E METODOLOGJISË SË MËSIMDHËNIES, FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë, neni 35 pika 2 dhe neni 49, pika e, në VKM Nr.418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen riorganizimin, ndarjen bashkimin ose mbylljen IAL dhe degëve të tyre, Në Udhëzimin e MASR nr. 1 datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë , degëve të tyre, njësjive kryesore dhe programeve të studimit si dhe ndarjen dhe bashkimin e IAL" të ndryshuar, në Vendimin Nr. ___ datë __.09.2021 të Senatit Akademik "Për disa ndryshime në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 17 Datë 25.09.2020 Për Hapjen E Programit të Studimit Master Profesional në "Mësues Ndihmës në Arsimin Gjithëpërfshirës" në Departamentin e Metodologjisë së Mësimdhënies, Fakulteti i Shkencave Të Edukimit", Bordi i Administrimit :

V E N D O S I:

1. Emërtimi i vendimit nr.38 datë 26.09.2020 i Bordit të Administrimit të bëhet: "*Për miratimin e hapjes e programit te studimit Master në "Mësuesi për arsimin special" në Departamentin e Metodologjisë së mësimdhënies, Fakulteti i Shkencave të Edukimit.*"
2. Pika 1 e Vendimit Nr.38, datë 26.09.2020 të bëhet : *Të miratojë hapjen e programit të studimit me Master në "Mësuesi për arsimin special", në departamentin e Metodologjisë së mësimdhënies, Fakulteti i Shkencave të Edukimit.*
3. Pika 2 e Vendimit ndryshohet dhe bëhet: *Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit Master në "Mësuesi për arsimin special" të jetë 2 vjet me 120 kredite.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian DËRMISHI